



## KËSHILLI DREJTUES I RTSH

### FTESE

Përshendetje,

Në emër të Këshillit Drejtues të RTSH-së dhe në bazë të vendimit nr 39 të datës 15.11.2019 (këtu bashkëlidhur), jam i autorizuar t'ju kontaktoj lidhur me paraqitjen e kandidaturave për Këshillin e Dëgjuesve dhe Shikuesve.

Këshilli i Dëgjuesve dhe Shikuesve është një detyrim ligjor për transmetuesin publik dhe shërben si forum konsultativ për ecurinë e tij.

Në bazë të nenit 112 të Ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" "Këshilli për shikuesit dhe dëgjuesit, në funksionimin e tij, duhet të sigurojë përfaqësimin e shikuesve dhe dëgjuesve dhe veçanërisht personave me nevoja të veçanta shqisore." Për lehtësi, po ju dërgojmë nenin e posacëm që lidhet me KSHD dhe shpjegon detyrat dhe funksionet e tij.

Duke besuar në bashkëpunimin tuaj dhe vlerësimin serioz të kërkesës, lutem dërgoni kandidaturat tuaja shoqëruar me një CV brenda datës **2 dhjetor 2019** për shqyrtim, në adresën: [www.kwshillidrejtues.rtsh.al](http://www.kwshillidrejtues.rtsh.al)

Ju faleminderit paraprakisht për bashkëpunimin,

Këshilli Drejtues i RTSH

Kryetari  
Kristaq Traja

#### Neni 112

Këshilli për shikuesit dhe dëgjuesit

1. RTSH-ja krijon Këshillin për Shikuesit dhe Dëgjuesit brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
2. Këshilli përbëhet nga 15 anëtarë, të zgjedhur nga KDRTSH-ja, mes anëtarëve të saj, gazetarëve ose punonjësve të tjerë të RTSH-së dhe të paktën dy të tretat prej tyre të jenë përfaqësues të jashtëm të kategorive të ndryshme shoqërore.
3. Këshilli për shikuesit dhe dëgjuesit, në funksionimin e tij, duhet të sigurojë përfaqësimin e shikuesve dhe dëgjuesve dhe veçanërisht personave me nevoja të veçanta shqisore
4. RTSH-ja i siguron këshillit kushtet për ushtrimin e funksioneve të këtij të fundit.
5. Këshilli për shikuesit dhe dëgjuesit mund t'i kërkojë RTSH-së, kur e shihet të nevojshme dhe të mundur, vëzhgime dhe studime lidhur me ndjekjen e shërbimeve të transmetimeve nga ana e të miturve dhe të rinjve, të moshuarve dhe kategorive të tjera të veçanta të shoqërisë.

Address: "Ismail Qemali" Street, No.11, Tirana, Albania





6. Në ushtrim të funksioneve të veta, këshilli mund të organizojë seanca dëgjimore në transmetime të drejtpërdrejta dhe të kërkojë nga RTSH-ja, për këtë qëllim, dy herë në vit vënien në dispozicion të paktën të një ore transmetimi, si në transmetimet e programit televiziv dhe në ato audio.
7. Këshilli për shikuesit dhe dëgjuesit harton një raport vjetor, në lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij, dhe ia paraqet KDRTSH-së, AMA-s, ministrit dhe Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik të Kuvendit.

